



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 80 dt. 09.10.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 09.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ristrukturimi i Sheshit Iliria”, nga Bashkia Durrës (faza e II).
2. Sipas Vendimit nr. 61, të dt. 15.09.2014 të KKR, lidhur me objektin e Shatërvanit, i cili ndodhet në Sheshin “ILIRIA”, u propozuan dy variante nga Bashkia e Durrësit, ku:

Miratohet vendosja e tij sipas variantit të dytë me këto kushte:

- Spostimin e shatërvanit në mes të lulishtes së sheshit para hyrjes së Portit.
 - Ngarkohet Bashkia e Durrësit për zhvendosjen dhe vendosjen e menjëhershme të tij, në sheshin e propozuar.
 - Ngarkohet Bashkia Durrës që në buxhetin e vitit 2015, të parashikojë fonde për sistemimin e sheshit para hyrjes së Portit si dhe restaurimin e fasadave të tij.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO TURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI